ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**206-23-651-1-1-1**
Nr. i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" Lot 2

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Flamur Isufi B.I.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtinë, 10, Vasil Andoni
(Adresa)

PRISHTINË — ***10 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/503-250 — ***N/A***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Flamur Isufi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

flamuri84@yahoo.com
(Adresa elektronike)

N.T.P. EXPORT IMPORT ERAMED PRISHTINË

11.08.2023
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 06.02.2023 Data e hapjes së ofertave dt. 28.03.2023 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 16.05.2023 Njoftimit për dhënie të kontratës ishte bërë me dt.24.05.2023 Njoftimi për anulim të dhënies së kontratës me dt.28.07.2023 Kërkesa për rishqyrtim: 01.08.2023 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: Nuk kemi pranu

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 9 i LPP-së** **Neni 26 i LPP-së** **Neni 108/A i LPP-së** **Neni 39.11 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik** **Neni 42.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik** **Neni 61.3 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë nga AK-ja ishte bërë me dt.16.02.2023, ndërsa hapja e ofertave ishte bërë me dt.12.04.2023 ku kishin marr pjesë katër operator ekonomik **për Lot 2**.

Njoftimi mbi vendimin ishte publikuar me dt.16.05.2023 ku ne ishim rekomanduar për kontratë për Lot 2.
Në lidhje me këtë njoftim nuk kishte pasur kërkesë për rishqyrtim e as ankesë.

Publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës nga AK-ja ishte bërë me dt.24.05.2023, e ku ishte planifikuar nënshkrimi i **kontratës për dt.24.05.2023.**
Më pastaj na ishte dërguar drafti i kontratës. Pas këtij veprimi ishte tërhequr drafti i kontratës nga ana e AK-së, kurse me dt.28.07.2023 ishte publikuar njoftimi për anulim të dhënies së kontratës, e ku ishin shenjëzuar arsyet si në vijim:

IV.4) Arsyeja e anulimit të njoftimit të dhënies së kontratës:
x Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit"
☐ Ri-vlerësim i aktivitetit të prokurimit.
x Anulim dhe Ri-tenderim i aktivitetit të prokurimit
x Një rekomandim i lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kërkon anulimin e njoftimit për dhënie te kontratës
☐ Ne përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 te LPP-se

Tek Rubrika V.2) informacionet shtesë është shënuar si në vijim:

Anulimi i Dhënies se kontratës për LOT 2 bëhet me kërkesën e Sekretarit te Përgjithshëm me Nr. protokolli 05-4516 te datës 24.07.2023, me te cilën ZKA e ka njoftuar ZPP te Divizionit te Prokurimit qe Andaj nga ana juaj kërkoj që të procedoni në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik në anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit . Sekretari i Përgjithshëm ka refuzuar ta nënshkruaj kontratën dhe ka kërkuar qe kontrata te anulohet, me arsyetimin se specifikat teknike janë hartuar ne mënyrë qe kanë favorizuar prodhues specifik, duke e kufizuar konkurrencën. Bazuar ne opinionin e KRPP-së, ZKA ka kërkuar ekspertizë nga njësia e Bankës Botërore, me çka bazuar ne opinionin e tyre është arritur ne përfundimin e këtij aktiviteti.

Pas këtij publikimi, ne kemi kërkuar qasje dhe na është lejuar qasja në dokumentacion.

Arsyetimi i AK-së për anulimin e dhënies së kontratës është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne jemi shpallur si tenderues të suksesshëm, pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, fakt ky i vërtetuar nga vet AK-ja, pasi që e njëjta na ka dërguar edhe draft-kontratën për këtë lot.
Përderisa është nënshkruar fillimisht raporti i vlerësimit nga komisioni vlerësues dhe nga ana e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, është publikuar njoftimi mbi vendimin dhe janë kaluar të gjitha çështjet procedurale të drejtës së ankesës dhe përderisa është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës, kuptohet qartë se janë përmbushur të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës sipas nenit 26 të LPP-së.
Refuzimi i ZKA për të nënshkruar kontratën është ndërhyrje direkte në proces të prokurimit dhe për më tepër ky veprim shpërfaq tendencë diskriminuese ndaj neve dhe favorizuese për ndonjë kompani të caktuar. Në vendimin për anulimin të dhënies së kontratës, nuk janë

dhënë arsye konkrete se përse është anuluar ky njoftim dhe përse është refuzuar nënshkrimi i kontratës nga ZKA.
Një vendim kundërligjor nga AK-ja për anulim të dhënies së kontratës (faza para nënshkrimit të kontratës) përveç që nuk duhet të ndodh pasi që nuk ka asnjë arsye për anulimin e këtij njoftimi, njëkohësisht neve na shkakton edhe dëme të mëdha materiale.
Anulimi i dhënies së kontratës me kërkesë të sekretarit të përgjithshëm përbën shkelje flagrante ligjore edhe nga ana e zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe njëkohësisht përbën ndërhyrje të paligjshme të sekretarit në procedurë tenderuese.
Specifikat teknike i harton njësia kërkuese dhe më pastaj janë kaluar filtrat e tjerë për vlerësim të ofertave, ndërsa në fund sekretari vjen me konstatim se janë përshtat specifikat prodhuesit specifik.

AK-ja e ka cekur opinionin e KRPP si bazë për të kërkuar ekspertizë nga njësia e Bankës Botërore dhe duke u bazuar në opinionin e tyre është përfunduar ky aktivitet i prokurimit.
Sa i përket këtij arsyetimi, ne kemi analizuar opinionin e KRPP-së të dt.29.06.2023 me Nr.46/23 e ku ky opinion absolutisht nuk i jep të drejtë AK-së dhe sekretarit që të anulojë njoftimin për dhënie të kontratë dhe absolutisht nuk theksohet se sekretari ka të drejtë të ndërhyjë në proces të prokurimit e as në fazën në të cilën ka ndërhy sekretari.
Përkundrazi opinioni në fjalë ka sqaruar kompetencat e ZKA dhe të Departamentit/njësisë së prokurimit, zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe fazat e procedurës së prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës.
Opinioni i KRPP-së në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast nuk i ka dhënë të drejtë sekretarit të përgjithshëm të ndërhyjë në procese të prokurimit dhe absolutisht nuk shpreh ndonjë opinion që në këtë rast është anuluar me të drejtë dhënia e kontratës por nuk flitet fare për raste konkrete, e leje më për këtë rast.
Pra opinioni i KRPP-së vetëm është përmendur dhe është interpretuar sipas dëshirës së AK-së përndryshe kur analizohet opinioni i KRPP-së, kuptohet që AK-ja me rastin e inicimit, vlerësimit dhe deri te njoftimi për dhënie të kontratës ka zbatuar procedurat e prokurimit ashtu siç përshkruan opinioni i KRPP-së.
Sa i përket ekspertizës së njësisë së Bankës Botërore në të cilën referohen, ne me qasje nuk kemi vërejtur ndonjë ekspertizë por ka pas një komunikim ndërmjet zyrtarëve të njësisë së Bankës Botërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë, mirëpo në këtë rast nuk ka ekspertizë dhe nuk mund ti thuhet këtij komunikimi apo mendimi ekspertizë, megjithatë ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me Ligjin e Prokurimit Publik që është në fuqi në Kosovës dhe nuk ka të bëjë me asnjë legjislacion të huaj apo të jashtëm.

Përpjekja që ti referohen ekspertizave dhe opinioneve të KRPP-së është vetëm një përpjekje për mbulesë dhe një përpjekje për tu arsyetuar Ministria e Shëndetësisë, mirëpo këto veprime janë tërësisht kundërligjore.

Me dt.24.07.2023 Sekretari i përgjithshëm i ka dërguar një shkresë Dr. Naser Ramadani - Drejtorit Ekzekutiv të IKSHPK ku ka sqaruar se nga divizioni i prokurimit i është dërguar kontrata për nënshkrim në lidhje me këtë tender, me çka kuptohet se përderisa i është dërguar kontratë për nënshkrim kuptohet që kjo kontratë është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i Prokurimit.

Po në atë shkrese ceket se me dt.21.07.2023 është informuar nga zyrtarët e Bankës Botërore se kriteret e tenderit kanë qenë të kopjuara nga prodhues specifik dhe se specifikat janë shumë të ngjashme me ato të:

1. Water still:LAUDA, Puridest PD 8 R
2. Incubator: POL- EKO, Laboratory Incubator CLN 115
3. Cooled incubator POL-EKO Cooled Incubator ST 3(partial similarity)
4. Sterilizator:POL- EKO, SL W 240 Smart
5. Water bath: LAUDA, Hydro H 16 A
6. Hot plate stirrer: AREX, Analog Stirrer 20L
7. Tube rotator: VËR, Tube Rotator,
8. Shaker 3D: OHAUS, Model SHRK04DG
9. Colony Counter: ISOLAB, Colony Counter

Nga ky tekst, e i cili i referohet mendimit të zyrtarëve të Bankës Botërore kuptohet qartë se askund nuk shkruan se ka përshtatje të specifikave por shkruan se janë të ngjashme dhe janë kopjuar nga prodhues specifik.
Pra shihet qartë se nuk ka përshtatje të specifikimeve, prandaj edhe brenda shkresave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe komunikimeve me zyrtar të bankës botërore ka mospërputhje dhe kundërthënie sepse edhe nga zyrtarë të bankës Botërore është thënë se specifikat janë të ngjajshme e nuk thuhet se janë të njëjta, pavarësisht që thuhet se ka kopjime nga prodhues specifik.
Nga të gjitha këto shkresa, kuptohet se tendenca e AK-së ka qenë diskriminimi dhe dëmtimi i kompanisë tonë.
Zyrtarët e njësisë së Bankës Botërore dhe sekretari i përgjithshëm nuk janë kompetent për specifikime teknike dhe për përgatitjen e tyre, por janë njësia kërkuese, e cila si çdo herë i përgatit specifikimet teknike.

Me veprimin e sekretarit të përgjithshëm duke i përfshirë në lojë edhe zyrtarë të njësisë së bankës botërore është vepruar kundërligjshëm dhe ky veprim është ndërhyrje në procedura të prokurimit.
SE NUK KA PAS PËRSHTATJE TË SEPCIFIKIMEVE TEKNIKE, NE PO JU BASHKANGJESIM NJË TABELË ME PRODHUES TË TJERË E KU KUPTOHET QË NUK ËSHTË KUFIZUAR KONKURRENCA.
Normalisht që ka edhe prodhues të tjerë, por në mungesë të kohës për dorëzim të kërkesës për rishqyrtim ne po e bashkangjesim tabelën që e cekëm më lartë.

Se kanë ekzistuar tendencat ndaj kompanisë tonë, e tregon fakti se me dt.24.05.2023 është planifikuar nënshkrimi i kontratës ndërsa rreth dy muaj më vonë bëhet anulimi i dhënies së kontratës nga AK-ja, pra me dt.27.07.2023. Pra është pritur dy muaj që të nxjerret njoftimi për anulim të dhënies së kontratës, e që nënkuptohet se është përgatitur dhe punuar në këtë drejtim rreth dy muaj për të gjetur ndonjë arsyetim për të mos nënshkruar kontratë me kompaninë tonë.
Në opinionin e KRPP-së është cekur shumë qartë që pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës AK brenda 30 ditëve kalendarike nënshkruan kontratën.

Pra opinioni i KRPP-së në këtë rast ka sqaruar dhe konstatuar shkeljen ligjore të sekretarit të përgjithshëm të MSH-së, ndërsa këto shkelje AK-ja i ka interpretuar në favor e tyre.

Pra në këtë anulim të dhënies së kontratës nuk ka opinion të KRPP-së për anulim të dhënies së kontratës, prandaj arsyeja e cekur se një Rekomandim i KRPP-së kërkon anulimin e dhënies së kontratës është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar.

Në këtë rast janë shkelur dispozitat e nenit 26 të LPP-së dhe 42.4 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim publik.
42.4 Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike.

Në këtë rast nuk është respektuar neni 26 i LPP-së nga Sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë në cilësinë e ZKA, sepse janë përmbushur të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës.

Ne me dt.01.08.2023 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim mirëpo nuk kemi marr përgjigje edhe pse kanë kaluar afti ligjor prej tri ditë pune dhe nuk kemi pranuar asnjë njoftim për zgjatje të afatit për vendimmarrje. Po ashtu ka kaluar afti ligjor prej 6 ditësh për të kthyer përgjigje dhe me këtë rast kemi mosrespektim të nenit 108/A të paragrafi 6 LPP-së dhe nenin 61.3 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se neve jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe po dëmtohemi materialisht.

AK-ja ka rënë në kundërshtim me veprimet e saj që i kishte bërë sipas nenit 59 të LPP-së, pra që kishte bërë vlerësimin e ofertave, e ku ishte nënshkruar raporti i vlerësimit prej anëtarëve të komisionit dhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.
Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që AK-ja ka mundur të thirret për të anuluar njoftimin për dhënie të kontratës dhe për më tepër veprimi i saj nuk është në harmoni me konsistencën që e ka pasur që nga fillimi i aktivitetit të prokurimit deri më tani, kurse tani ka vepruar në kundërshtim të plotë me të gjitha veprimet e mëparshme.
Duke pasur parasysh këto fakte, rezulton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për nënshkrim të kësaj kontrate dhe se veprimi i ZKA në këtë rast është jashtë kompetencave të tija ligjore dhe nuk e ka respektuar nenin 26 të LPP-së.
Veprimi i ZKA është pikërisht cenim i integritetit dhe përgjegjësive të zyrtarëve që kanë qenë të përfshirë në inicim, hartim të specifikave, vlerësim të ofertave dhe në procedurën e prokurimit e cila ka arritur deri para nënshkrimit të kontratës.
Veprimi i ZKA është ndërhyrje tipike e kundërligjshme sepse vendimi final për dhënien e kontratës është përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit (ZPP) dhe këtë e parasheh dispozita si në vijim:

39.11 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator

ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk është nënshkruar kontrata, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa në këtë rast është vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë.

Rastet të tilla ka pasur edhe më herët kur ka pas ndërhyrje nga ZKA, ndërsa OSHP-ja nuk kishte lejuar që të ndodhin kësi shkelje p.sh ekspertiza me Nr.425/22 e dt.06.10.2022, Vendimi Nr. 425/22 i dt.15.12.2022 dhe urdhëresa e dt.20.12.2022 me Nr.425/22.
Prandaj ne presim që të veprohet edhe në këtë rast njëjtë sikurse në ë kaluarën dhe të zbatohen praktikat e OSHP-së.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Flamur Isufi B.I., LOT 2**
ANULOHET njoftimi për anulim të dhënies së kontratës e AK-së (B11) dhe të vazhdohet me procedura të nënshkrimit të kontratës sipas nenit 26 të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 4,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*